



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.A.nr.16/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Murat Peqanit anëtar i Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Fushë Kosovë, paraqitur kundër Artan Asllanit nga subjekti politik Iniciativa Socialdemokrate e Ashkalive, me seli në Fushë Kosovë, për shkeljes se dispozitave të Kodit të Miresjelljes për periudhën e fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë: 13.12.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET e palejuar ankesa e Murat Peqanit anëtar i Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Fushë Kosovë, paraqitur kundër Artan Asllanit nga subjekti politik Iniciativa Socialdemokrate e Ashkalive, me seli në Fushë Kosovë, për shkeljes se dispozitave të Kodit të Miresjelljes për periudhën e fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 28 Dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 10.12.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën e parashtruar nga Murat Peqani anëtar i Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Fushë Kosovë, në të cilën thekson se ish deputeti nga komuniteti ashkali dhe njëherit kandidat për deputet nga Iniciativa Socialdemokrate e Ashkalive, Artan Asllani po krijon përçarje dhe nxitje të urrejtjes, duke postuar pa lejen e tij të dhënat personale dhe duke nxitur masën dhe aktivistët kundër tij. Parashtruesi i ankesës thekson se Artan Asllani në rrjetin social ka publikuar fotografi personale të cilat janë janë realizuar disa vite më parë dhe duke bërë thirrje në masë se kinse është duke bërë tradhëti konbëtare ndaj ashkalive. I njëjti kërkon që të merren masa pasi që po ndihet nën presion për të vazhduar punën e tij si anëtar i KKZ-së në Fushë Kosovë.

Në përgjigjen në ankesë të Artan Asllani subjektit politik Iniciativa Socialdemokrate e Ashkalive, thekson se pretendimi se janë publikuar fotografi "të disa viteve më parë" nuk qëndron. Fotografia dhe materiali i publikuar lidhen drejtpërdrejt me zgjedhjet e 28 dhjetorit 2025, pasi Partia Liberale Egjiptiane (PLE) garon me numrin 120, që është numër zyrtar i këtyre zgjedhjeve. Prandaj materiali është aktual, jo i vjetër. Të gjitha informacionet që kam publikuar kanë qenë të natyrës publike. Asnjëra nga të dhënat nuk ka qenë personale apo private. Ato janë informacion publik i qasshëm për këdo. Këtë e dëshmojnë edhe videot dhe materialet që kam dorëzuar në ankesën time zyrtare në protokollin nr. 9, ku shihet qartë se publikimi i tyre është bërë në kontekst të aktiviteteve politike publike dhe jo private. Nuk ka

pasur asnjë qëllim nxitje të urrejtjes apo presioni. Publikimi është bërë për transparencë, pa asnjë element gjuhë urrejtjeje denigrimi apo cenimi të integritetit personal. Në publikimin tim nuk ekziston asnjë shprehje që do të mund të interpretohej në kundërshtim me Kodin Zgjedhor. Qytetarët kanë të drejtë të informohen për angazhimet politike të personave që mbajnë poste zgjedhore. Kjo është veçanërisht relevante për anëtarët e KKZ-së, të cilët duhet të jenë neutralë gjatë procesit zgjedhor. Nuk kam shkelur asnjë dispozitë ligjor. Të gjitha veprimet e mia janë brenda kuadrit të transparencës së lejuar dhe nuk përbëjnë publikim të të dhënave personale apo cenim privatësie. Duke qenë se pretendimet e ankuesit janë të pabazuara dhe të pashoqëruara me prova, kërkoj që ankesa të refuzohet si e paargumentuar.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas administrimit të pretendimeve ankimore, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Rregulla Zgjedhore e KQZ-së Nr.15/2024 Zgjedhjet e Parakohshme dhe të Jashtëzakonshme neni 2 paragrafi 2 nën paragrafi 2.18 përcakton: *se një ditë pas shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme dhe/apo të jashtë zakonshme, KQZ nxjerr vendim për caktimin e afateve kohore dhe planin e aktiviteteve për zgjedhje për:..... 2.18 fushatën zgjedhore si dhe afatet për tubimin e fushatës zgjedhore.*

Sipas nenit 34 dhe 44 i Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, përcaktohen veprimet e ndaluara të subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore të subjekteve politike, mbështetësve të tyre ose kandidatët e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore si dhe të drejtat e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore sipas kushteve të saktësuara në Kodin e Sjelljes.

KQZ-ja me vendimin me nr. protokolli 01/3395-2025 i datës 24.11.2025 ka miratuar planin kohorë të aktiviteteve për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të datës 28 Dhjetor 2025, në të cilin plan ka përcaktuar se periudha për fillimin e fushatës zgjedhore fillon nga data 17.12.2025 dhe zgjat deri më datën 28.12.2025 në ora 06:59.

Andaj duke u bazuar në vendimin e lartcekur të KQZ-së, si dhe në dispozitat e lartcekura ligjore me të cilën përcaktohen veprimet e ndaluara të subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore si dhe duke pasur parasysh se pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë nga pala ankuese janë zhvilluar para datës zyrtare të caktuar për fushatë zgjedhore, Paneli konstaton se ankesa në fjalë është e palejuar ngase as me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme e as me Rregullat Zgjedhore nuk është paraparë sanksionimi apo marrja e masave tjera ligjore për këtë periudhë të para fushatës zgjedhore.

Bazuar në arsyet e sipërsënuara dhe në kuptim të 115 par.1 dhe nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht” dhe Nenit 13.3 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZP.A.nr.16/2025, datë: 13.12.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.